

**No. 53564\***

---

**United States of America  
and  
Albania**

**Treaty between the Government of the United States of America and the Government of the Republic of Albania concerning the encouragement and reciprocal protection of investments (with annex and protocol). Washington, 11 January 1995**

**Entry into force:** *4 January 1998, in accordance with article XVI*

**Authentic texts:** *Albanian and English*

**Registration with the Secretariat of the United Nations:** *United States of America, 20 April 2016*

*\*No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.*

---

**États-Unis d'Amérique  
et  
Albanie**

**Traité entre le Gouvernement des États-Unis d'Amérique et le Gouvernement de la République d'Albanie relatif à l'encouragement et à la protection réciproque des investissements (avec annexe et protocole). Washington, 11 janvier 1995**

**Entrée en vigueur :** *4 janvier 1998, conformément à l'article XVI*

**Textes authentiques :** *albanais et anglais*

**Enregistrement auprès du Secrétariat des Nations Unies :** *États-Unis d'Amérique, 20 avril 2016*

*\*Le numéro de volume RTNU n'a pas encore été établi pour ce dossier. Les textes reproduits ci-dessous, s'ils sont disponibles, sont les textes authentiques de l'accord/pièce jointe d'action tel que soumises pour l'enregistrement et publication au Secrétariat. Pour référence, ils ont été présentés sous forme de la pagination consécutive. Les traductions, s'ils sont inclus, ne sont pas en form finale et sont fournies uniquement à titre d'information.*

[ ALBANIAN TEXT – TEXTE ALBANAIS ]

**T R A K T A T**

**MIDIS**

**QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE  
DHE QEVERISE SE SHTETEVE TE BASHKUARA TE AMERIKES  
MBI NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TE INVESTIMEVE**

Qeveria e Republikes se Shqiperise  
dhe

Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, (ketu me poshte  
"Palet"),

Duke deshירuar te nxisin nje bashkepunim ekonomik me te madh  
midis tyre, ne lidhje me investimet e shtetasve dhe shoqerive te  
njeres Pale ne territorin e Pales tjeter;

Duke pranuar qe marreveshja lidhur me trajtimin qe do t'u jepet  
investimeve te tilla do te stimuloje hyrjen e kapitalit privat  
dhe zhvillimin ekonomik te Paleve;

Duke gene dakord qe nje kuader i qendrushem per investimet do te  
rrise ne maksimum perdorimin efektiv te burimeve ekonomike dhe  
do te permiresoje standartin e jeteses;

Duke ditur qe zhvillimi i lidhjeve ekonomike dhe tregtare mund  
te rrise respektin per te drejtat e punonjesve, te njohura  
boterisht;

Duke rene dakort qe keto objektiva mund te arrihen pa lene  
menjane zbatimin ne pergjithesi te masave per ruajtjen e  
shendetit, te sigurise dhe mjedisit; dhe

Duke vendosur te perfundojne nje Traktat ne lidhje me nxitjen dhe  
mbrojtjen e ndersjellte te investimeve;

u muaren vesh per sa vijon:

**NENI 1**

**PERCAKTIME**

Per qellimet e ketij Traktati,

- (a) "shoqeri", nenkupton çdo entitet te krijuar apo te organizuar sipas legjislacionit ne fuqi, me ose pa perfitim, te zoteruar apo te kontrolluar privatisht ose nga qeveria, dhe perfshin nje korporate, trust, bashkepronesi, nje pronar te vetem, filial, ndermarrje te perbashket, shoqate, apo organizim tjeter;
- (b) "shoqeri e nje Pale", nenkupton nje shoqeri te krijuar apo te organizuar sipas legjislacionit te asaj Pale;
- (c) "shtetas" i nje Pale, nenkupton nje person fizik i cili eshte shtetas i asaj Pale sipas legjislacionit te saj ne fuqi;
- (d) "investim" i nje shtetasi apo shoqerie nenkupton çdo lloj investimi te zoteruar apo te kontrolluar direkt ose indirekt nga ai shtetas ose nga ajo shoqeri, dhe perfshin investimin qe konsiston apo merr formen e :
  - (i) nje shoqerie;
  - (ii) aksioni, letrave me vlere, interesave te bashkepronesise, dhe forma te tjera te pjesemarrjes ne pasuri, obligacioneve, detyrimeve dhe forma te tjera te interesave te huave, ne nje shoqeri;
  - (iii) te drejtave kontraktuale, te tilla si kontrata objektesh me çeles ne dore, kontrata menaxhimi apo ndertimi, kontrata prodhimi apo te ndarjes te te ardhurave, koncesione, ose kontrata te tjera te ngjashme;
  - (iv) pasurise se prekshme, perfshire pasurine e patundshme; dhe pasurise se paprekshme, perfshire te drejta te tilla si dhenie me qera, hipotekat, franshizen dhe pengjet;
  - (v) pronesise intelektuale, duke perfshire:
    - te drejten e autorit dhe te drejta qe lidhen me te,
    - patentat,

- te drejttat mbi varietetet e bimeve,
  - dizajnet industriale,
  - te drejttat mbi projektet e gjysem-perçuesave,
  - sekretet tregtare, perfshire know-how dhe informacionet konfidenciale te tregttise,
  - markat tregtare dhe te sherbimit, dhe
  - emra tregtare; dhe
- (vi) te drejttat te dhena ne pajttim me ligjtin, te tilla si licencat dhe lejet;
- (e) "investim i mbuluar" nenkupton nje investim te nje shtetasi ose shoqerie te njeres Pale ne territorin e Pales tjetere;
- (f) "ndermarrje shteterore" nenkupton nje shoqeri ne pronesi ose te kontrolluar nepermjet interesave te pronesise, nga njera Pale;
- (g) "autorizim investimi" nenkupton nje autorizim qe jepet nga Autoriteti i Investimeve te Huaaja i njeres Pale per nje investim te mbuluar apo nje shtetas apo shoqeri e Pales tjetere;
- (h) "marreveshje investimi" nenkupton nje marreveshje te shkruar midis autoriteteve kombetare te njeres Pale dhe nje investimi te mbuluar ose nje shtetasi ose nje shoqerie te Pales tjetere e cila
- (i) jep te drejttat ne lidhje me burimet natyrore ose pasuri te tjera qe kontrollohen nga autoritetet kombetare dhe,
  - (ii) mbeshtet investimin, shtetasin ose shoqerine ne krijimin ose sigurimin e nje investimi te mbuluar.
- (i) "Konventa ICSID" nenkupton Konventen mbi Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve mbi Investimet midis Shteteve dhe Shtetasve te Shteteve te tjere, bere ne Washington me 18 Mars 1965.
- (j) "Qender" nenkupton Qendren Nderkombetare per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve mbi Investimet te vendosur nga Konventa e ICSID; dhe
- (k) "Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL" nenkupton Rregullat e Arbitrazhit te Komisionit te Kombeve te Bashkuara mbi Ligjtin e Tregttise Nderkombetare.

## **NENI II**

### **TRAJTTIMI I INVESTIMIT**

1. Ne lidhje me krijimin, pervetesimin, zgjerimin, drejttimin, udheheqjen, aktivitetin dhe shitjen ose dispozita te tjera

te investimeve te mbuluara, secila Pale do te akordoje trajtim jo me pak te favorshem se sa ai qe ajo i akordon, ne situata te ngjashme, investimeve ne territorin e saj, shtetasve ose shoqerive te saj (ketu me poshte "Trajtim Kombetar") ose investimeve ne territorin e saj te shtetasve ose shoqerive te nje vendi te trete (ketu me poshte "Trajtimi i Kombit me te Favorizuar), cili do qofte me i favorshmi (Ketu me poshte "Trajtimi Kombetar dhe i Kombit me te favorizuar"). Sejcila Pale do te siguroje qe ndermarrjet e saja shtetere, ne sigurimin e mallrave ose sherbimeve te tyre, te akordojne trajtim kombetar dhe te kombit me te favorizuar per investimet e mbuluara.

2. (a) Njera Pale mund te miratoje ose te ruaje perjashtime lidhur me detyrimet e paragrafit 1 ne sektoret ose ne lidhje me ceshtjet te specifikuara ne Aneksin e ketij Traktati. Ne miratimin e nje perjashtimi te tille, njera Pale nuk mund te kerkoje heqjen, pjeserisht apo teresisht, te investimit te mbuluar ekzistues ne kohen kur perjashtimi do te behet efektiv.
- (b) Detyrimet e paragrafit 1 nuk zbatohen per procedurat qe parashikohen ne Marreveshjet Multilaterale te perfunduara nen vemendjen e Organizates Boterore te Pronesise Intelektuale ne lidhje me pervetesimin ose ruajtjen e te Drejtave te Pronesise Intelektuale.
3. (a) Sejcila Pale ne çdo kohe, do t'i akordoje investimeve te mbuluara, nje trajtim te drejte dhe te barabarte dhe nje mbrojtje e sigurim te plote dhe ne asnje rast nuk do te akordoje trajtim me pak te favorshem se sa ai qe kerkohet nga e Drejta Nderkombetare.
- (b) Asnjera nga Palet nuk do te demtoje me asnje menyre, me masa te pa arsyeshme dhe diskriminuese drejtimin, udheheqjen, aktivitetin, dhe shitjen ose dispozita te tjera te investimeve te mbuluara.
4. Sejcila Pale do te siguroje mjete efektive per mbrojtjen e reklamimeve dhe per forcimin e te drejtave lidhur me investimet e mbuluara.
5. Sejcila Pale siguron qe ligjet, rregullat, praktikat administrative dhe procedurat e aplikimit ne pergjithesi, dhe vendimet gjyqesore qe kane te bejne me ose ndikojne ne investimet e mbuluara, do te publikohen menjehere ose do te vihen ne dispozicion per publicitet.

### **NENI III**

#### **SHPRONESIMI**

1. Asnjera Pale nuk do te shpronesoje apo shtetezoje nje